




REPUBLIKA E KOSOVES		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIJE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	20	Nr Prot	01-333/16
Dep.		B Prot	
Nr i lartë	02	Prot No	
B. Organizata		Data	28.01.2016
		Datum	
		Që	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.01.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4291/15, për zyrtarin e lartë z. Musaj Tërbunja, Drejtor në Komunën e Vushtrrisë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshëm të Konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokollit AKK-03-02-4291/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Musaj Tërbunja, Drejtor në Komunën e Vushtrrisë .**

Gjatë procesit për identifikimin e rasteve të dyshuara për konflikt të mundshëm të interesit, është identifikuar rasti për zyrtarin e lartë z. Musaj Tërbunja, Drejtor në Komunën e Vushtrrisë. Është vërejtur se zyrtari i lartë ka të regjistruar një biznes privatë dhe figuron si person i autorizuar në këtë biznes e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin të funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 24.11.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z.Musaj Tërbunja, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, të ngarkuar me rastin dhe është njoftuar për situatën në të cilën gjendet.

Gjatë bisedës me zyrtarin është pajtuar me gjendjen dhe na ka njoftuar se do të bëjë kërkesë për shuarje të biznesit dhe do të mundohet që brenda afatit ligjor do të sjell dëshmitë lidhur me shuarjen e këtij biznesi .

Agjencia kundër Korrupsionit duke parë që zyrtari nuk ka sjell dokumentet për shuarje i kemi bërë edhe shkresën e dytë ku i kemi dhënë afat sipas nenit 18.8 të Ligjit Nr.04/L-051.

Ne ndërkohë kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se biznesi me emër N.P.N “RIGONI ” me pronar Musaj Tërbunja me nr.70582600 është shuar në mënyrë vullnetare.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Musaj Tërbunja, Drejtor në Komunën e Vushtrrisë dukë bërë shuarjen vullnetare të biznesit privat janë krijuar rrethana të reja, dhe konstatojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues )

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

